



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1237/11prot.

Tiranë, më 02.12. 2025

V E N D I M

Nr. 280, datë 02. 12.2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën me nr.197 Regj., datë 16.09.2025² të znj. M. M., kundër znj. Sh. G., Drejtoreshë e Qendrës Socio-Shëndetësore Vorë, në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “*bindjeve politike/filozofike*” dhe “*çdo shkak tjetër*”³.

K O N S T A T O N:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit ankuesja parashtron ndër të tjera se: *Unë e nënshkruara M. N. M., e lindur më datë 27.01.1994 në Iballë, Pukë, në një familje të arsimuar dhe me tradita e kulturë shqiptare, kam pasur fatin të rritem e të edukohem nga dy prindër të mrekullueshëm me profesion mësues (babai) dhe infermiere (nëna), të cilët më kanë transmetuar ndjenjën e përgjegjësisë dhe të përkushtimit për punën. Jam nënë e një djali 4-vjeçar.*

Në vitin 2019 jam diplomuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në fushën penale, Master Shkencor. Në vitin 2020 jam përzgjedhur nga Ministria e Drejtësisë për të bërë praktikën

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Plotësuar dhe saktësuar me informacionin e administruar pranë Komisionerit me nr. 1237/3 prot., datë 29.09.2025.

³ Sa i përket çdo shkak tjetër, ankuesja ka pretenduar se znj. G., ka kryer parregullsi dhe veprime të paligjshme gjatë ushtrimit të detyrës së saj si eprore. Këto problematika, ankuesja ia ka përcjellë edhe institucioneve përkatëse hierarkike.

në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Fushën Penale. Pas përfundimit të praktikës me sukses, më është ofruar punë në pozicionin e specialistes në këtë drejtori. Kam punuar me përkushtim, korrektësi dhe profesionalizëm dhe jam vlerësuar nga përgjegjësja ime asaj kohe znj. L. K., dhe drejtuesja znj. O. F., (bashkëlidhur dokumenti, Letër reference e nënshkruar nga znj. O. F.). Kam punuar për një vit pranë kësaj drejtorie dhe më pas jam larguar me leje lindje dhe, duke qenë se duhej t'i përkushtohesha djalit tim të sapolindur, nuk jam kthyer në punë.

Në vitin 2023, pasi fëmija im ka filluar të shkojë në çerdhe, kam filluar të kërkoj përsëri punë. Kam parë njoftimin për punë nga OSHKSH, në linkun "Vende Pune". Njoftimi ishte për pozicionin e punës Juriste pranë QSSH Vorë. Kam kaluar të gjitha fazat e procesit të punësimit me sukses dhe kam filluar punë në datën 23.07.2023. Ky është fillimi i gjithë problemeve që do të tregoj në vijim.

Kur kam filluar punë pranë QSSH Vorë, nuk ka pasur dosje të punonjësve, as kontrata, as dokumentacion të mbajtur në rregull e me sistem. Më është dashur të krijoj nga e para një sistem për mbajtjen e dokumentacionit dhe të ndërtoja zyrën e burimeve njerëzore në mënyrë që të lehtësohej puna për mua dhe gjithë punonjësit e tjerë. Gjithashtu, kam njoftuar punonjësit për të drejtat dhe detyrimet e tyre në punë. Punonjësve u ishin shkelur për vite me radhë të drejtat nga drejtuesja e kësaj qendre. Ka pasur inspektime nga Inspektorati i Punës dhe kanë gjetur shkelje të cilat janë të dokumentuara në dosjet e qendrës.

Duke qenë se i vija në dukje shkeljet e rënda administrative dhe ligjore që kjo drejtoreshë kryente në mënyrë sistematike, u gjenda përballë një sjelljeje diskriminuese, arrogante dhe fyese nga znj. G. Duke qenë se unë isha e re në punë si juriste pranë kësaj qendre shëndetësore dhe e re në profesion, drejtuesja më trajtonte si të paaftë profesionalisht dhe më kërkonte me insistim që të bëhesha palë me të për të shkelur të drejtat e punonjësve. Rast specifik janë kërkesat e saj për të larguar nga puna në mënyrë të padrejtë dhe në mosrespektim të Kodit të Punës disa punonjës (Dr. E. B., Mjeke laborante; Xh. O., Sanitare). Për të gjitha këto shkelje kam vënë në dijeni organet eprorë deri tek Ministria e Shëndetësisë. Të gjitha këto veprime dhe dhunë psikologjike që ka zgjatur për rreth një vit, kam kuptuar që janë bërë për shkak të diskriminimit që më është bërë për arsyet e mëposhtme.

Bindjet filozofike. Znj. G., më kërkonte të vazhdoja në të njëjtën mënyrë që ishte mësuar ajo të punonte, duke shkelur të gjitha parimet në të cilat unë besoja dhe ndiqja. Më kërkonte shpesh herë që të bëja veprime që binin ndesh me etikën e punës; për shembull, më ka kërkuar të heq nga puna njerëz duke pretenduar që unë të hartoja shkresa dhe të gjeja një "arsye" për t'i larguar nga puna punonjësit me të cilët ajo kishte konflikte personale. Gjithashtu, më ka kërkuar të jap informacion për procedura që nuk më lejohej të jepja informacion, duke pretenduar se në këtë mënyrë do të ndihmonte në ecurinë e punës. Mënyra se si ajo punonte ishte diametralisht e kundërt me mënyrën time të punës. Ajo pretendonte që të shkelja etikën e punës, Kodin e Punës dhe çdo rregull tjetër për të arritur qëllimet e saj. Unë i vija në dijeni shkeljet që ishin kryer në vite. Një rast konkret

është punësimi i psikologes znj. A. A., në QSSH Vorë, në shkelje të ligjit, për shkak se znj. A., nuk ishte dhe nuk është ende e licencuar për të punuar si psikologe. Pas këtij njoftimi nuk është marrë asnjë masë për psikologjen apo personat përgjegjës për punësimin e saj. Përkundrazi, unë jam thirrur në Drejtorinë Rajonale të OSHKSH-së dhe jam qortuar se kam nxjerrë në pah këtë shkelje. Konkretisht më është thënë: “Kush je ti që i kërkon licencën psikologes? Atë e kanë emëruar njerëz të tjerë.. etj..” Për të më bërë mua me faj për gjithë këto shkelje, janë shtuar dokumenta fiktive në protokollin e QSSH Vorë.

Bashkëlidhur kësaj ankese janë të gjitha shkresat që vërtetojnë sa më sipër; një ndër to është komunikimi me punonjësen e protokollit për shkresën e protokolluar nga ajo pas 6 muajsh me qëllime për të më dëmtuar figurën time si jurist duke shpikur.

Për këtë shkresë fiktive jam thirrur në Drejtorinë Rajonale të OSHKSH nga z. L. H., duke më shënjestruar për sjelljen time ndaj kryeinfermieres që kjo zonjë kishte bërë ankesë për mua në këtë drejtori. Gjatë kësaj mbledhjeje ju doli në pah i gjithë rrugëtimi diskriminues që kishte bërë drejtuesja znj. G., në bashkëpunim me kryeinfermierën e kësaj qendre znj. S. D., kundrejt meje. M’u kërkuar nga z. H., që të bëja një relacion të të gjithë shkeljeve të rastit të paraqitur nga ana ime në mënyrë shkresore, të cilën e bëra dhe e dërgova pranë kësaj drejtorie dhe nuk mora asnjë përgjigje. (Bashkangjitur shkresa “Relacion” mbi drejtuesen e QSSH Vorë).

Një tjetër arsye për diskriminimin tim kanë qenë bindjet politike. Gjatë fillimit të fushatës për zgjedhjet qendrore të vitit 2025 jam thirrur nga drejtuesja për të marrë pjesë në çdo mbledhje dhe në fushatën e znj. E. S., (kandidate e Partisë Socialiste në qarkun e Tiranës, në konkretisht, Vorë). Pas insistimit të drejtoreshës për të marrë pjesë në këto takime, pasi ajo më bënte presion me pozicionin tim të punës, unë nuk kam pranuar. Znj. G., e dinte që unë kam qenë pjesë e strukturave të Forumit Rinor të Partisë Demokratike (bashkëlidhur karta e anëtarësimit), presioni shtohet dhe më shumë. Unë, duke qenë e sigurt për aftësinë time dhe për faktin që punën e kisha fituar në mënyrë të drejtë, refuzova vazhdimisht të merrja pjesë në këto takime.

Kjo ka sjellë përkeqësim të situatës time të punës duke filluar nga janari i vitit 2025. Jeta ime në vazhdim u kthye në një makth. Gjatë gjithë kësaj periudhe jam ndjerë e survejuar nga kamerat e instaluar në QSSH Vorë të cilat kjo drejtuese i ka të instaluar në telefonin e saj personal. Kjo për shkak që ajo të më detyronte të bëja çfarë donte ajo ose të më gjente në shkelje për të më hequr nga puna. Presioni rritej vazhdimisht me komunikime verbale, me email. Më thërriste në dhomën e shërbimit parësor më shumë se 20 herë në ditë me qëllim që të më vështirësonte punën dhe unë të largohesha. Presioni i ushtruar ndaj meje dhe koleges time ekonomiste pranë qendrës, gjithashtu i dokumentuar në emisionin investigativ “Fiks Fare” të datës 27.03.2025.

Për shkak të gjithë këtyre presioneve të vazhdueshme u gjenda përballë problemeve shëndetësore të cilat më ishin shkaktuar nga kjo periudhë e gjatë pune nën presion psikologjik dhe kërcënime të vazhdueshme. Unë kam jetuar çdo ditë me frikën se kjo drejtoreshë do të bënte shkresa të

paligjshme apo do të gjente një mënyrë tjetër për të më kaluar në ndjekje penale ose të më fuste në burg. Ky ka qenë qëllimi i saj që nga momenti i parë që konfliktet tona kanë filluar.

Pas gjendjes time të përkeqësuar shëndetësore (të vërtetuar me raporte shëndetësore bashkëlidhur këtu) të shkaktuara gjatë kohës time të punës pranë kësaj qendre, probleme si çrregullime të ankthit, stresit, gjendje paniku, etj., jam detyruar të jap dorëheqjen e menjëhershme dhe të pa revokueshme në datën 11.04.2025.

Dorëheqja ime ishte e detyruar pasi u bë e pamundur për mua që të funksionoja normalisht dhe të isha në gjendje të kujdesesha për veten, familjen dhe në veçanti për fëmijën tim 3-vjeçar.

Pavarësisht kësaj, kanë vazhduar përndjekjet në numrin personal dhe në emailin personal nga drejtoresha. Ata donin të më detyronin të paraqitesha pranë Qendrës Shëndetësore. Duke pasur frikë për arsyet që më kërkonin të paraqitesha me aq insistim, kam refuzuar të shkoj. Duke qenë se përndjekja nuk ka ndaluar, i jam drejtuar me mesazh (bashkëlidhur këtu komunikimi) Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-se, drejtorit z. L. H., dhe i kam kërkuar të merren masa që drejtoresha të mos më përndjekë më sepse po ndikon negativisht në gjendjen time shëndetësore. Dua të theksoj se kam vënë në dijeni Drejtorinë Rajonale, Drejtorinë Qendrore, Ministrinë e Shëndetësisë dhe FSDKSH Kamëz-Vorë për një periudhë 3 mujore (nga janari deri në mars) për humbjen e dokumentave të ndryshëm që unë konstatoja çdo ditë në zyrën time. Nuk kam marrë asnjëherë përgjigje nga asnjë institucion. Kjo e ka shtuar frikën time për çfarë mund të ndodhte me mua nëse këto dokumenta ishin hequr nga dosjet në mënyrë të qëllimshme nga drejtoresha e qendrës.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të konstatojë diskriminimin që i është bërë dhe të vlerësojë të gjitha pasojat që kanë ardhur si rrjedhojë e këtij diskriminimi. Duke qenë se i është dashur të ndjekë trajtim mjekësor pranë mjekëve psikiatër për një periudhë të gjatë kohe dhe nuk ka qenë në gjendje të ushtrojë profesionin për një periudhë të konsiderueshme, ajo kërkon që të merret në konsideratë mundësia e kompensimit moral dhe material, si për kostot e kurimit, ashtu edhe për humbjen ekonomike që më është shkaktuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke garantuar në mënyrë të shprehur mbrojtje në lidhje me shkakun e gjendjes arsimore dhe çdo shkak tjetër. Në nenin 1, të LMD përcaktohet: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose

shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Në nenin 12/1/c, të LMD përcaktohet: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.*”

Bazuar në nenin 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkaqet e pretenduara nga ana e subjektit ankues dhe lidhjen shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur, në raport me subjektet nga të cilët pretendon se diskriminohet, apo me të drejtën ligjore të saj.

Me shkresën nr. 1237/2 prot., datë 17.09.2025 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është kërkuar nga ankuesja të depozitojë informacion të mëtejshëm në lidhje me çështjen, si më poshtë vijon:

- Të saktësohen shkaqet e pretenduara për diskriminim, pasi në dy formularët e ankesës të plotësuar nga ana juaj janë paraqitur shkaqe të ndryshme, të cilat duhet të qartësohen në mënyrë të saktë për të identifikuar shkaqet konkrete dhe të vërteta mbi të cilat mbështetet ankesa.
- Shpjegime më të hollësishme në lidhje me shkaqet e pretenduara për diskriminim, duke përcaktuar qartë cila është karakteristika, apo veçantia që ju e mbartni dhe që prezumohet

të ketë ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese. Ky informacion duhet të shoqërohet me fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë se ju i mbartni këto shkaqe të pretenduara.

- Përveç përshkrimit të shkaqeve, është e nevojshme të sqarohet në mënyrë të qartë se si këto shkaqe kanë ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin që ju konsideroni diskriminues. Ju lutemi të përshkruani lidhjen midis rrethanave të paraqitura dhe pasojave konkrete që keni përjetuar për shkak të tyre.
- Nga shqyrtimi i ankesës dhe formularëve të dorëzuar, rezulton se janë dhënë data të ndryshme në lidhje me momentin kur ka ndodhur ngjarja që pretendohet si diskriminuese dhe datën kur jeni vënë në dijeni për të. Në këtë kontekst, ju lutemi të saktësoni në mënyrë të qartë dhe të plotë datën, muajin dhe vitin kur ka ndodhur ngjarja përkatëse, si dhe datën kur keni marrë dijeni për këtë situatë.
- Informacion nëse, i keni adresuar shqetësimet për diskriminimin tek institucionet e prapë: nëse po, ju lutemi të na vini në dispozicion kopje e ankesës si dhe përgjigjen e kthyer nga institucioni.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju do e gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj.

Me shkresën nr. 1237/3 prot., datë 29.09.2025 është administruar pranë Institucionit të Komisionerit, informacion shtesë në lidhje me plotësimin e ankesës.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar dhe ajo u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1237/3 prot., datë 06.10.2025, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Qendra-Socio Shëndetësore Vorë, Drejtoria Rajonale Tiranë dhe Ministria e Shëndetësisë, si më poshtë:
 - Parashtrimet nga çdo institucion përkatës (*QSSH Vorë, Drejtoria Rajonale e OSHKSH-së, Ministria e Shëndetësisë,*) lidhur me pretendimet e znj. M., ku ajo deklaron se ka vënë në dijeni organet përkatëse për problematikat në vendin e saj të punës.
 - Kopje të dosjes personale të znj. M. M., pranë institucionit tuaj.
 - Kopje të kontratës individuale të punës së znj. M., e firmosur mes palëve.
 - Detyrat funksionale të saj sipas kontratës së punës dhe rregullores së institucionit, përfshirë përshkrimin e punës si juriste pranë QSSH Vorë.
 - Informacion mbi vlerësimet e performancës së saj gjatë periudhës së punësimit.

- Informacion nëse janë marrë masa disiplinore ndaj znj. M., gjatë ushtrimit të detyrës. Nëse po, kërkojmë kopje të plotë të akteve dhe të procedurës së ndjekur për marrjen e këtyre masave.
 - Informacion nëse ankuesja ka paraqitur kundërshtime apo ankesa me shkrim, në rrugë administrative, lidhur me qëndrimet dhe veprimet e znj. G., shkaqet e dorëheqjes apo pretendime për diskriminim. Nëse po, kërkojmë kopje të shkresave të paraqitura nga znj. M., si dhe përgjigjet zyrtare nga institucioni juaj.
 - Kopje të Rregullores së Brendshme të Qendrës Socio-Shëndetësore, Vorë.
 - Kopje të kontratës kolektive, nëse ekziston një e tillë në fuqi për institucionin në fjalë.
 - Informacion dhe dokumentacion mbi situatën me znj. S. D., përfshirë çdo akt zyrtar që shpreh qëndrimin institucional lidhur me ankesën e saj dhe marrëdhënies së saj me ankuesen.
 - Informacion mbi pretendimin për humbje të dokumentacionit nga zyra e znj. M., dhe çdo verifikim apo veprim i ndërmarrë në lidhje me këtë çështje.
 - Informacion mbi kamerat e sigurisë të instaluar në ambientet e QSSH Vorë: numri i tyre, qëllimi i instalimit, dhe nga kush administrohen pamjet filmike.
 - Informacion nëse ndonjë prej këtyre çështjeve është objekt i një procesi gjyqësor në zhvillim ose të përfunduar.
 - Informacion nëse ndonjë organ kompetent ka ndërmarrë veprime konkrete apo ka mbajtur qëndrim zyrtar në lidhje me problematikën e trajtuar në emisionin investigativ “Fiks Fare”, të datës 27.03.2025.
 - Çdo informacion tjetër plotësues, që ju e gjykoni të nevojshëm për zbardhjen e plotë të kësaj çështjeje.
2. Me shkresën nr.719 prot., datë 13.10.2025⁴ të Qendrës Socio-Shëndetësore Vorë është përcjellë pranë Komisionerit informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar me shkresën nr.1237/3 prot., datë 06.10.2025, në lidhje me ankesën, duke parashtruar faktet si më poshtë vijon:

Qendra Socio-Shëndetësore Vore, është një institucion publik që ofron shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor në njësinë bazë e cila ndodhet në Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë/Njësinë Administrative Vore. Struktura dhe organizimi i QSH miratohet nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, shërbimeve të kujdesit shëndetësor bazuar në të dhënat e marra nga Njësia e Kujdesit Shëndetësor Tiranë. Ofrimi i shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor bazohet në:

1. *Statusin e QSSH (miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale).*
2. *Paketën bazë të kujdesit shëndetësor parësor.*
3. *Kontratën e QSSH Vore (lidhet çdo fillim viti me DRF–Kamëz–Vore).*

⁴ Administruar pranë Komisionerit me nr.1237/5 prot., datë 22.10.2025.

4. Rregulloren e brendshme e QSSH Vore (miratohet çdo vit nga DROSHKSH Tiranë).

Ndryshimet e organizimit dhe të strukturës së QSH vijnë nga OSHKSH dhe Ministria. Qendra shëndetësore duhet të njoftojë me shkrim DRF/FSDKSH. Qendra shëndetësore ka detyrim të zbatojë legjislacionin shqiptar, aktet nënligjore në fuqi, udhëzimet dhe urdhrat e nxjerra nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor dhe autoritetet shëndetësore vendore të autorizuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

Qendra Socio-Shëndetësore Vore funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi për kujdesin shëndetësor parësor dhe me Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Parimet kryesore që përcakton ky ligj janë në nenin nr. 3, ku ligji liston disa parime që nëpunësit duhet t’i respektojnë kur kryejnë funksionet e tyre: - Veprim në përputhje me ligjin, respektimi i normave ligjore dhe legjislacionit në fuqi. - Pavarësi nga influenca politike, mos të ketë ndikim politik në punën profesionale. - Ndershmëri, paanshmëri, efikasitet, duke pasur si orientim vetëm interesin publik. - Sjellje e mirë me qytetarët dhe kolegët, respekt për të drejtat dhe interesat e të tjerëve. - Parandalimi i konfliktit të interesit, të mos lejohet që interesat private të ndikojnë në funksionin publik. - Ruajtja e besimit publik në administratë, që publiku të besojë në ndershmëri, drejtësi dhe efektivitet të shërbimeve publike. – Konfidencialitet i informacionit që mban nëpunësi, përveç rasteve kur ligji kërkon transparencë (p.sh. ligji për të drejtën e informacionit).

QSSH-Vore respekton parimet dhe zbaton legjislacionin për shërbimin civil/shëndetësor publik dhe Kodin e Punës, bazuar në vlerësime profesionale dhe jo në kritere diskriminuese.

Në vijim të shkresës suaj nr. 1237/4 prot., datë 06.10.2025, lidhur me ankesën e znj. M. N. M., depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me nr. regj. 197 datë 16.09.2025, nga Qendra Shëndetësore Vore, pasi është njohur me përmbajtjen e ankesës, paraqet si më poshtë:

Znj. M. M, ka qenë e punësuar pranë Qendrës Socio-Shëndetësore Vore, në pozicionin e juristes me kontratë të rregullt pune, duke filluar nga data 18.07.2023 me nr. 371 prot. Punësimi i saj është bërë në përputhje me procedurat nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, pas përzgjedhjes në platformën “Vende Pune”. Detyrat funksionale të juristes janë përcaktuar në mënyrë të qartë në kontratën e punës dhe në përshkrimin e vendit të punës, në përputhje me strukturën organizative dhe rregulloren e brendshme të QSSH-Vore. Qendra ka vepruar sipas këtyre dokumenteve, duke i kërkuar znj. M., ushtrimin e detyrave të përcaktuara në to. Gjatë ushtrimit të detyrës znj. M., ka pasur të gjitha të drejtat dhe kushtet e barabarta me punonjësit e tjerë të qendrës pa asnjë diferencim për arsye bindjesh politike, filozofike apo personale. Në asnjë rast znj. M., nuk i janë ngarkuar detyra jashtë atyre të përcaktuara në kontratën e punës. Të gjitha detyrat i janë kërkuar në përputhje me fushën e saj profesionale dhe me legjislacionin në fuqi për administratën publike dhe shërbimin shëndetësor.

Në datën 11.04.2025, znj. M., ka paraqitur dorëheqjen me shkrim, të firmosur prej saj, duke kërkuar ndërprerjen e menjëhershme dhe të parevokueshme të punës, për arsye personale dhe shëndetësore, protokolluar me datë 15.04.2025 nr. 262 prot. Në këtë moment institucioni nuk ka më detyrim të analizojë apo kthejë përgjigje administrative për vazhdimësinë në punë. Dorëheqja e saj është pranuar dhe proceduar në përputhje me nenin 151 të Kodit të Punës. Pas paraqitjes së dorëheqjes së parevokueshme nga ana e ish-juristes, QSSH-Vore ka dërguar shkresa zyrtare në adresë të znj. M., për ta njoftuar mbi detyrimin për dorëzimin e dokumentacionit dhe detyrave të papërfunduara të punës. Këto shkresa janë kthyer mbrapsht nga shërbimi postar pasi nuk janë tërhequr nga znj. M.

Për pasojë, institucioni ka përmbushur detyrimin ligjor për njoftim dhe nuk mban përgjegjësi për mosparaqitjen apo mosbashkëpunimin e ish-punonjësës në procesin e dorëzimit të detyrës.

Në paragrafin ku flitet për dokumentacionin e Qendrës Socio-Shëndetësore Vore, duke cituar se nuk ka pasur dosje, ju informoj se:

Qendra Socio-Shëndetësore Vore është akredituar në vitin 2022 dhe është vlerësuar me 93% të standardit mbi ofrimin e shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor. Dokumentat gjenden të protokolluara sipas rregullit nga personi përgjegjës. Viti 2023 ishte vazhdimi i vitit të punës ku konsiston ruajtja, përditësimi dhe zbatimi i rregulloreve dhe ligjit. Me ardhjen e ish-juristes znj. M. M., në vitin 2023 (ishim prej 9 muajsh pa jurist) i gjithë dokumentacioni (dosjet e punonjësve) i mbajtur në drejtori iu delegua znj. M. Pas delegimit iu dhanë udhëzimet përkatëse mbi vazhdimin e punës. Njëkohësisht iu deleguan edhe detyrat që ekonomistja mbante nga ana e juridiksionit, duke menduar që ajo do ta vazhdonte punën me profesionalizëm. Këtu rrëzojmë në mënyrë kategorike ankesën mbi pretendimin e znj. M., ku shprehet se i është dashur të ndërtonte zyrën e Burimeve Njerëzore.

Sa i përket instalimit të kamerave të sigurisë: Ato janë vendosur në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Qëllimi i kamerave të sigurisë është të mbrojnë:

- Personelin dhe pacientët.*
- Pasurinë e institucionit,*

si dhe të parandalojnë apo hetojnë ngjarje të paligjshme “vjedhje, dhunë, etj.”. Kamerate janë të vendosura vetëm në ambientet e përbashkëta (hyrje, korridore, oborr), me sinjalistikë njoftuese të dukshme dhe ruhen për një periudhë maksimale rreth 22 ditë.

Në përfundim:

Në përfundim të shqyrtimit të brendshëm administrativ, Qendra Socio-Shëndetësore Vore vlerëson se nuk janë konstatuar elemente që të provojnë ekzistencën e diskriminimit institucional ndaj znj. M. M. Institucioni ynë mbetet i hapur dhe i gatshëm të bashkëpunojë.

3. Me shkresën nr. 1237/6 prot., datë 22.11.2025 të Komisionerit iu përcoll ankueses informacioni dhe dokumentacioni shoqërues i Qendrës Socio-Shëndetësore Vorë, për të paraqitur kundërshtimet e saj në lidhje me këtë përgjigje.
4. Me shkresën nr. M-26/3 prot., datë 22.10.2025⁵ Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, ka dërguar një informacion të detajuar të shoqëruar me dokumentacionin përkatës, ku ndër të tjera informon se:

Në vijim të shkresës tuaj me nr. 1237/4 prot., datë 06.10.2025, protokolluar me tonën nr. M-2612 prot., datë 07.10.2025, me objekt: “Njoftim dhe kërkesë për informacion”, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, ju informojmë si më poshtë:

Pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale janë administruar:

- Shkresa e znj. S. D., kryeinfermiere pranë Qendrës Socio-Shëndetësore Vore, me datë 07.03.2025, protokolluar me tonën nr. 0-12 prot., datë 10.03.2025, me objekt: “Kërkesë”, ku shprehte shqetësimet në vendin e punës dhe problematikat me juristen e kësaj qendre, znj. M. M. (bashkëlidhur).
- Shkresa e Qendrës Socio-Shëndetësore Vore me nr. 210 prot., datë 28.03.2025, protokolluar me tonën nr. 1544 prot., datë 02.04.2025, me objekt: “Relacion mbi situatën e krijuar në Qendrën Socio-Shëndetësore Vore”, lidhur me problematikat e krijuara nga juristja e qendrës, znj. M. M. (B) (bashkëlidhur).
- Shkresë për dijeni MSHMS-së me datë 14.04.2025, protokolluar me tonën nr. M-26 prot., me objekt: “Dorëheqje e parevokueshme”, nga znj. M. M.
- MSHMS-ja, me datë 26.06.2025, e delegoi për kompetencë pranë Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Tiranë dhe për dijeni pranë Drejtorisë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, shkresën me nr. 0-1211 prot., të znj. S. D., kryeinfermiere pranë Qendrës Socio-Shëndetësore Vore.
- Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, në datë 10.07.2025, i ka kthyer përgjigje MSHMS-së me shkresën nr. 1765/1 prot., protokolluar me tonën nr. M-2611 prot., datë 14.07.2025, lidhur me kërkesën e znj. S. D., ku informon ndër të tjera se juristja e Qendrës Socio-Shëndetësore Vore, znj. M. M., ka dhënë dorëheqjen e parevokueshme (bashkëlidhur).

Për sa më sipër, MSHMS-ja, referuar Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 04.07.2018, “Për

⁵ Administruar pranë Komisionerit me nr.1237/7 prot., datë 24.10.2025

krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”, me datë 26.06.2025, ka deleguar për kompetencë shkresën nr. 0-12/1 prot., pranë institucionit të Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Tiranë dhe për dijeni Drejtorisë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, pasi shkresa me objekt “Dorëheqje e parevokueshme” nga znj. M. M., është procedurë që ndiqet nga këto dy institucione.

5. Me shkresën nr.2747/1 prot., datë 21.10.2025⁶ të Drejtorisë Rajonale Tiranë, është përcjellë pranë Komisionerit informacioni në lidhje me çështjen, si më poshtë:

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 1236/4 prot., datë 06.10.2025, me lëndë “Njoftim dhe kërkesë për informacion”, protokolluar me tonën nr. 2747 prot., datë 07.10.2025, me anë të së cilës kërkonti informacion dhe përgjigje mbi kërkesën tuaj nr. 1236/4, datë 06.10.2025, me lëndë: “Njoftim dhe kërkesë për informacion”, protokolluar në institucion me nr. 2747, datë 07.10.2025, nëpërmjet së cilës kërkonti informacion në lidhje me ankesën për diskriminim të znj. M., të paraqitur pranë institucionit që ju përfaqësoni, ju informojmë si më poshtë:

Në muajin mars 2025, pas disa ankesave dhe problematikave ndërmjet punonjësve të QSSH Vore, është zhvilluar një takim i thirrur nga drejtori, në prani të drejtoreshës së QSSH-së, znj. G., dhe juristes së kësaj qendre, znj. M. Në këtë takim u diskutua në lidhje me ankesat, por nuk u arrit një marrëveshje. Në kërkesën që u bë për t’i paraqitur këto ankesa nëpërmjet një relaconi shpjegues të detajuar, nuk është marrë asnjë masë administrative pasi është vlerësuar të zgjidhet midis komunikimit, bashkëpunimi dhe reflektimit.

Nga QSSH Vore na është vënë në dispozicion një kërkesë për verifikim raporti për juristen M. M. Nga grupi i kontrollit të ngritur për verifikimin e raportit, rezultoi se raporti mjekësor në fjalë nuk ishte konform legjislacionit në fuqi.

Drejtorja Rajonale e OSHKSH Tiranë mbetet në pritje të çdo vlerësimi apo rekomandimi nga ana e institucionit tuaj.

6. Me shkresën nr. 1237/9 prot., datë 06.11.2025 janë administruar pranë Institucionit të Komisionerit, parashtrimet e ankueses ku shprehet se:

Në vijim të shkresës suaj Nr. 1237/6 Prot., datë 22.10.2025, paraqes këto kundërshtime, duke përfshirë çdo fakt dhe rrethanë që kam evidentuar deri tani në lidhje me atë çfarë thuhet në shkresë.

Për sa i përket kamerave të instaluar në QSSH Vorë, theksoj dhe vërtetoj se znj. Sh. G., i ka pasur gjithë kohës të instaluar në telefonin e saj personal iPhone. Kamerat i shikonte 24/7 në telefonin e saj. Unë disponoj foto të gjithë ambientit të Qendrës Socio-Shëndetësore, ku verifikohet qartë dhe

⁶ Administruar pranë Komisionerit me nr.1237/5 prot., datë 22.10.2025.

saktë që nuk ka asnjë tabelë që njofton se kamerat janë nën survejim. Tabelat i ka vendosur vetëm në momentin kur i ka ardhur shkresa nga Komisioni i Diskriminimit, dhe mund të bëhen verifikimet nga kamerat e qendrës pasi ato kamera kanë një hard disk të madh dhe nuk fshihen çdo 20 ditë, siç e referon znj. Sh. G., përveç rasteve kur i fshin ajo vetë personalisht, siç ka bërë gjithmonë për çdo incident (të cilën e kam të dokumentuar pas regjistrimit të denoncimit tim në Komisariatin nr. 3 Tiranë).

Theksoj se znj. G., ka shkelur hapur Ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe Udhëzimin nr. 03, datë 30.04.2025, “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video-surveimit”.

Gjatë gjithë periudhës së punës sime në këtë qendër, nuk është ngritur asnjë urdhër për krijimin e një grupi për verifikimin e kamerave në rast vjedhjeje, aksidenti apo rasti tjetër. Po ashtu, në asnjë pikë të rregullores së kësaj qendre nuk rezulton të flitet për verifikimin e kamerave dhe instalimin e tyre.

Pas dorëheqjes sime, nuk jam njoftuar nga Qendra Socio-Shëndetësore apo nga drejtoresha znj. G. Më ka ardhur vetëm një email, ku më kërkon me ngulm të paraqitem pranë kësaj qendre, pa asnjë arsye të cituar. I kam kërkuar që për çdo gjë të më njoftojë në adresën postare, ashtu siç e përcakton ligji.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim për shkaqet e pretenduara të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë, Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë.

Bazuar në informacionin dhe dokumentacionin e administruar nga Qendra Socio-Shëndetësore Vorë, Drejtoria Rajonale Tiranë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, rezulton se ankuesja M. N. M., ka qenë e punësuar pranë QSSH-Vorë në pozicionin Juriste, me kontratë të rregullt pune, duke filluar nga data 18.07.2023, pas përzgjedhjes në platformën “Vende Pune”.

Gjatë periudhës së punësimit, znj. M., ka ushtruar detyrat e përcaktuara në kontratën e punës dhe në përshkrimin e vendit të punës, në përputhje me strukturën organizative dhe rregulloren e brendshme të institucionit, sipas deklarimeve të QSSH-Vorë.

Sipas dokumentacionit, gjatë periudhës së punësimit të ankuses janë shfaqur disa problematika të brendshme ndërmjet stafit të QSSH-Vorë, përfshirë ankesa të depozituara nga stafi i qendrës ndaj znj. M., si dhe një takim sqarues i zhvilluar në prani të drejtuesve të institucionit por dhe të institucioneve hirarkike. Nuk rezulton të jenë marrë masa administrative ndaj ankuses.

Në datën 11.04.2025, znj. M., ka paraqitur dorëheqje të menjëhershme dhe të përvokueshme, e protokolluar me datë 15.04.2025, për arsye personale dhe shëndetësore. Dorëheqja është pranuar në përputhje me nenin 151 të Kodit të Punës. Pas largimit, institucioni ka dërguar njoftime zyrtare për dorëzimin e dokumentacionit, të cilat janë kthyer mbrapsht nga shërbimi postar për shkak të mosparaqitjes nga ankuesja.

Sipas dokumentacionit të administruar të vënë në dispozicion nga palët rezulton se:

Qendra Socio-Shëndetësore Vorë (QSSH-Vorë) është institucion publik i kujdesit shëndetësor parësor, në varësi të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë. Institucioni ka për detyrë të sigurojë shërbime shëndetësore parësore për komunitetin lokal, duke përfshirë vizita mjekësore, shërbime infermieristike, mbikëqyrje të pacientëve kronikë dhe administrimin e dokumentacionit shëndetësor. Funksionimi i institucionit bazuar në ligj dhe rregullore të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale siguron ligjshmëri, ndershmëri, ruajtje të konfidencialitetit dhe respektim të parimeve të etikës profesionale.

Znj. M. M., e datëlindjes 27.01.1994, është diplomuar në vitin 2019 në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, me profil në fushën penale, duke përfunduar gjithashtu Masterin Shkencor. Në vitin 2020, u përzgjedh nga Ministria e Drejtësisë për të kryer praktikën në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Fushën Penale. Pas përfundimit të suksesshëm të praktikës, i u ofrua pozicioni i specialistes në të njëjtën drejtori.

Në datë 18.07.2023, znj. M. N. M., u emërua si juriste e QSSH-Vorë, me kontratë pune nr. 371 prot., pas procesit të përzgjedhjes në platformën “Vende Pune”. Ajo u ngarkua me detyrat e dokumentacionit juridik të qendrës, përfshirë dosjet e punonjësve dhe çështjet e tjera juridike që më parë administroheshin nga ekonomistja. Për një periudhë prej 9 muajsh, institucioni kishte mungesë juristi dhe puna e znj. M., ishte normalizimi i procesit ligjor dhe administrativ. Detyrat e saj ishin të përputhshme me fushën profesionale dhe kontratën e punës.

Gjatë periudhës së punës të znj. M., kanë ndodhur incidente në mënyrë të vazhdueshme me disa punonjës të Qendrës, përfshirë edhe drejtoreshën e Qendrës.

Referuar Relacionit nr. 210 prot., datë 28.03.2025 të Qendrës Socio-Shëndetësore Vorë dhe akteve të administruara, të cilat na janë vënë në dispozicion (*ankesa, kërkesa, procesverbale dhe relacione mbi situatat e ndryshme*) nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë me shkresën nr. M-26/3 prot., datë 22.10.2025, rezulton që: Që në ditët e para të punës, juristia është konfrontuar me kryeinfermierën, e cila ka bërë ankesë se është akuzuar nga znj. M., për lëvizjen e një qese me dokumenta. Incidenti u sqarua, por më pas është pretenduar se juristia e ka fyer kryeinfermierën dhe e akuzoi për vjedhje dokumentash, menjëherë pas ankesës së kryeinfermierës në operator.

Gjatë tre muajve të parë, znj. M., rezulton se ka debatuar dy herë me ekonomisten me tone të larta. Në rastin e parë shqetësimi u raportua nga psikologjia e pranishme gjatë debatit, ndërsa në rastin e dytë juristja kërcënonte ekonomisten se do njoftonte policinë. (*Referuar relacionit*)

Më 30 gusht 2023 rezulton se ka ndodhur një konflikt mes juristes dhe recepsionistes, ku drejtoresha e Qendrës ishte prezent. Incidenti u dokumentua në një relacion të detajuar.

Më 11 janar 2024, juristja rezulton të ketë debatuar dhe ofenduar sanitaren znj. H. I. Debat ka perfunduar me kërkim-falje nga juristja pas rreth një viti, pasi gjatë kësaj periudhe palët mbajtën pozicionet e tyre.

Gjatë hartimit të kontratës për psikologun, juristja nuk pranoi një nga nenet, situatë që u sqarua nga drejtoria rajonale.

Juristja dhe dr. E. B., dërguan ankesa përmes e-mail, duke u akuzuar reciprokisht. Në email-in e znj. M., përveç ankesës për mjeken, ajo ka akuzuar dhe Drejtoreshën e Qendrës për presion psikologjik. Drejtoria Rajonale ka informuar se nuk do të merrej zgjidhje pa analizë të mëtejshme të rastit.

Gjatë periudhës së punës rezulton se kanë ndodhur edhe konflikte të tjera nga ana e juristes dhe me punonjësit e shërbimeve të ujësjellësit dhe internetit, ku juristja ka patur mosmarrëveshje dhe ka akuzuar drejtuesen për procedura të dyshimta.

Rezulton se juristja ka patur debate dhe me ekonomisten provizore znj. A. H., e cila është shprehur se nuk mund të punonte më me juristen dhe u detyrua të largohej nga grupi i administratës.

Gjatë gjithë këtyre incidenteve, Drejtoria e Qendrës është shprehur se ndërhyri individualisht për të këshilluar punonjësit që të ruanin etikën dhe të mos ofendonin njëri-tjetrin.

Znj. M., përsëriti akuza ndaj drejtueses për manipulim të kamerave të sigurisë, presion mbi tenderime dhe për pagesa parkimi, duke pretenduar probleme të shumta, pretendime të cilat nuk u konfirmuan nga specialistët dhe stafi. Ajo pati incidente edhe me parkimin e makinës së saj, probleme me shërbimin e internetit dhe deklarime publike në emisionin “Fiks Fare”, duke akuzuar drejtuesen për procedura prokurimi që nuk përputheshin me realitetin.

Duke marrë shkas nga akuzat në emisionin “Fiks Fare, më datë 28.10.2024, në Komisaratin e Policisë Nr. 7 është bërë një kallëzim penal nga Qendra Socio-shëndetësore Vorë për konstatimin e disa problematikave. Një nga këto ishte verifikimi i kamerave. Pasi u bë kallëzimi pranë Komisaritit Nr. 7 për kontrollin e problematikave, erdhi ndihmë specialisti për hetimin e krimeve, Inspektor i Dytë E. H. Pas shqyrtimit të kamerave, nuk u konstatuan ndërhyrje apo ndryshim të të dhënave.

Në përfundim të kontrollit të kamerave, punonjësi i policisë ka këshilluar se kamerat duhet të regjistroheshin pak më lart, në mënyrë që rrezja e regjistrimit të ishte më e madhe dhe të mos mbulonte vetëm pjesë të caktuara, pasi një pjesë e spitalit ishte jashtë fushës së regjistrimit dhe kamerat e sigurisë nuk mund të filmonin shumë hapësira.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë bindjet politike dhe gjendjen shëndetësore, si shkaqe të mbrojtura. Ndërkohë Protokollu 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), e ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993, garanton në nenin 11 të drejtën e gruas për trajtim të barabartë në fushën e punësimit. Kjo dispozitë parashikon që gratë të mos diskriminohen për shkak të shtatzënisë, lindjes apo përgjegjësiwe prindërore dhe i detyron shtetet palë të ndalojnë pushimin nga puna për këto arsye. Konventa garanton gjithashtu të drejtën e gruas për të rifilluar punën pas përfundimit të lejes së lindjes, pa u penalizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për shkak të gjendjes së saj familjare apo shëndetësore.

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*⁷, sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar ndër të tjera në gjendjen shëndetësore dhe bindjet politike të personit.

*Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës*⁸ “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit, në fushën e

⁷ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

⁸ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes së barazisë, mundësive ose trajnimit, në punësim dhe profesion. Konventa garanton mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe opinionit politik.

*Karta Sociale Europiane*⁹ parashikon të drejtën për punë në nenin 1 të saj. Në vijim, në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet hprehimisht: “Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakut të tillë si racë, ngjyrë, seks, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindje ose statusi tjetër”.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Bazuar në nenin 21 të Kodit të Punës, kontrata e punës lidhet me shkrim dhe konsiderohet e vlefshme kur punëmarrësi pranon kryerjen e një pune ose shërbimi për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar. Në rastin konkret, ankuesja, znj. M. M., duke filluar nga data 18.07.2023, është përzgjedhur përmes platformës “Vende Pune” dhe ka nisur kryerjen e detyrave të saj sipas kontratës.

Më datë 11.04.2025, znj. M., ka paraqitur dorëheqje të menjëhershme dhe të parevokueshme, e cila është protokolluar me datë 15.04.2025, për arsye personale dhe shëndetësore. Dorëheqja është pranuar në përputhje me nenin 151 të Kodit të Punës.

Pavarësisht konflikteve dhe situatave të krijuara gjatë periudhës së punësimit në QSSH-Vorë, rezulton se çdo problematikë është adresuar nga ana e drejtueses së institucionit, e cila ka qenë gjithmonë e predispozuar për të ofruar këshilla dhe udhëzime, duke organizuar takime sqaruese dhe duke ndërmarrë veprime për zgjidhjen e situatave në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe pa përdorur

⁹ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

masa administrative ndaj ankueses. Gjatë gjithë kësaj periudhe, nuk rezulton që ndaj znj. M., të jenë ndërmarrë masa disiplinore.

Referuar konflikteve të konstatuara gjatë periudhës së punës së znj. M., rezulton se ato kanë pasur karakter individual dhe lidhen kryesisht me marrëdhënie personale ndërmjet punonjësve, duke u bazuar jo mbi detyra konkrete të punës, por kryesisht mbi keqkuptime, supozime dhe pretendime të palëve, të cilat nuk kanë pasur ndikim në mbarëvajtjen e institucionit. Drejtuesja e Qendrës ka ndërhyrë vazhdimisht për t'i sqaruar, këshilluar dhe udhëzuar palët në përputhje me nenet përkatëse të Kodit të Punës dhe rregulloren e brendshme, duke respektuar parimin e barazisë së trajtimit, integritetin moral të punonjësve dhe pa ndërmarrë masa disiplinore të papërshtatshme por me ndërhyrje verbale, udhëzime dhe këshilla të drejtpërdrejta për ruajtjen e etikës dhe harmoninë në ambientin e punës. Konfliktet nuk kanë pasur karakter kolektiv dhe janë menaxhuar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, duke ruajtur funksionimin normal të QSSH-Vorë dhe respektuar të drejtat dhe detyrimet ligjore të punonjësve.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesja mbi emërimin e znj. A. A., rezulton se drejtuesja e Qendrës, pas marrjes së dijenisë, ka dërguar shkresën nr. 197/Prot., datë 06.03.2024, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Tiranë. Drejtoria Rajonale ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 758/1/Prot., datë 13.03.2024, ku saktësohet se znj. A. A., psikologe pranë QSSH-Vorë, është emëruar përmes thirrjes së hapur të portalit “Mjekë për Shqipërinë” në kuadër të procedurave për punësimin e psikologëve në QSSH-Vorë, Tiranë, në tetor 2022. Procedura është kryer në përputhje me Udhëzimin nr. 571, datë 07.10.2022 “Për procedurat e rekrutimit të punonjësve psikologë dhe punonjësve social në strukturat publike shëndetësore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Komisioni i vlerësimit ka shqyrtuar dhe vlerësuar dosjet e aplikantëve sipas këtij udhëzimi, duke siguruar transparencën dhe ligjshmërinë e procesit (*bashkëngjitur, fleta e regjistrimit nr. 2197 e regjistrimit të licensimit*).

Referuar pretendimeve të ankueses mbi supozimet për shkelje të procedurave të tenderimeve dhe veprime të paligjshme nga drejtuesja e QSSH Vorë, si dhe mbi ushtrimin e presionit dhe kërcënimeve për të ndërhyrë në mënyrë të paligjshme, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe provave të administruara rezulton se nuk ka elemente të mbështetura faktikisht që të konfirmojnë pretendimet e saj. Të gjitha akuzat mbi shkelje të ligjit, manipulime dokumentash, apo veprime për detyrim të ankueses për të kryer veprime të kundërta me ligjin dhe rregulloren e brendshme mbeten të paprovuara dhe të deklaruara vetëm në formë subjektive. Nuk rezulton asnjë provë konkrete që të vërtetojë ndërhyrje të paligjshme ose kërcënime reale për kryerjen e veprimeve të pretenduara; dokumentacioni zyrtar dhe shkresat e institucionit tregojnë se çdo çështje e ngritur është trajtuar dhe sqaruar sipas procedurave ligjore dhe rregullores së brendshme.

Këto konstatime janë bërë edhe nga institucionet hierarkike, të cilave shqetësimi i ankueses është përcjellë për informacion dhe verifikim, si dhe nga vetë drejtuesja e Qendrës, duke vlerësuar se pretendimet e ankueses mbeten deklarative dhe pa mbështetje faktike në dosjet e QSSH Vorë.

Në lidhje me akuzat e ngritura në emisionin “Fiks Fare” më datë 28.10.2024, Qendra Socio-shëndetësore Vorë ka bërë një kallëzim penal pranë Komisarariatit të Policisë Nr. 7 për disa problematika të konstatuara, përfshirë edhe verifikimin e kamerave të sigurisë. Specialist i hetimit të krimeve, Inspektor i Dytë E.H., ka kryer kontrollin e kamerave dhe nuk janë konstatuar ndërhyrje apo ndryshim të të dhënave të regjistruara. Pas shqyrtimit, punonjësi i policisë ka këshilluar vendosjen e kamerave në pozicione më të larta për të përfshirë një hapësirë më të madhe dhe për të shmangur mbulimin e pjesshëm të ambientit. Ky rast është trajtuar dhe verifikuar nga institucionet kompetente, duke konfirmuar se nuk ka elemente që mbështesin pretendimet e ankueses për manipulim të kamerave ose shkelje të tjera ligjore.

Në këtë kontekst, Komisioneri vëren se:

- Emërimi i znj. M. M., dhe fillimi i detyrës së saj më datë 18.07.2023 është kryer në përputhje me kriteret e shpallura publikisht në platformën “Vende Pune” dhe në zbatim të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë (neni 21).
- Më datë 11.04.2025, znj. M., ka paraqitur dorëheqjen e saj të menjëhershme dhe të parevokueshme, e cila është protokolluar më datë 15.04.2025 për arsye personale dhe shëndetësore, e pranuar sipas nenit 151 të Kodit të Punës.
- Gjatë gjithë periudhës së punës, pavarësisht konflikteve individuale ndërmjet punonjësve, drejtuesja e QSSH Vorë ka ndërhyrë për t’i sqaruar dhe këshilluar palët, duke përdorur vetëm udhëzime dhe ndërhyrje verbale, pa ndërmarrë masa disiplinore të paarsyeshme. Konfliktet kanë pasur karakter personal dhe nuk kanë ndikuar në funksionimin normal të institucionit.
- Procedura e emërimit të znj. A. A., si psikologe është kryer në përputhje me thirrjen e hapur të portalit “Mjekë për Shqipërinë” dhe Udhëzimin nr. 571, datë 07.10.2022, për rekrutimin e punonjësve psikologë dhe socialë. Komisioni i vlerësimit ka shqyrtuar dhe vlerësuar dosjet e aplikantëve sipas udhëzimit, duke garantuar transparencën dhe ligjshmërinë e procesit.
- Referuar pretendimeve të ankueses mbi shkelje të procedurave të tenderimeve, veprime të paligjshme nga drejtuesja, si dhe ushtrim presioni dhe kërcënimesh, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nuk ekzistojnë prova faktike që mbështesin këto pretendime. Të gjitha akuzat mbeten të paprovuara dhe deklarative. Këto konstatime janë vërtetuar edhe nga institucionet hierarkike dhe nga vetë drejtuesja e Qendrës.
- Në lidhje me akuzat në emisionin “Fiks Fare” më datë 28.10.2024, është bërë kallëzim penal pranë Komisarariatit të Policisë Nr. 7 dhe është kryer verifikimi i kamerave nga specialisti i hetimit të krimeve. Nuk janë konstatuar ndërhyrje ose ndryshime në të dhënat e regjistruara. Punonjësi i policisë ka dhënë vetëm këshilla për vendosjen e kamerave në mënyrë që të mbulojnë hapësira më të mëdha.

Në përfundim, Komisioneri konstaton se, nga ana e Qendrës Socio-Shëndetësore Vorë, veprimet e ndërmarra gjatë periudhës së punës së znj. M. M., janë kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi,

rregulloret e brendshme dhe procedurat e përcaktuara për marrëdhëniet e punës. Pretendimet e ankueses për shkelje ligjore, manipulim dokumentash, ushtrim presioni ose kërcënime mbeten të pabazuara në fakte dhe prova. Nuk rezulton që ndaj znj. M., të jenë ndërmarrë masa disiplinore ose të kenë ndodhur pasoja të tjera negative, dhe dorëheqja e saj është shprehur si vullnet i lirë, për arsye personale dhe shëndetësore. Ky konstatim përforcon se çdo çështje e ngritur nga ankuesja është trajtuar në mënyrë ligjore, transparente dhe të paanshme, dhe nuk ka prova që të mbështesin pretendimet e saj.

Sa më sipër, rezulton se çdo shqetësim apo problematikë e ngritur nga ankuesja është marrë në konsideratë dhe është adresuar në kohë nga drejtuesja e Qendrës, duke u sqaruar dhe komunikuar me institucionet hierarkike përkatëse sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve të brendshme. Kjo ka garantuar trajtim të drejtë, transparencë dhe respekt të plotë të të drejtave të punonjësve, duke siguruar që çdo çështje e ngritur të shqyrtohej në mënyrë të paanshme dhe të dokumentuar.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Në nenin 12/1/c) të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohej diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Sa më sipër, mbështetur në ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, referuar provave të administruara nuk rezultoi se ankuesja është vendosur në pozita të pabarabarta apo të pafavorshme nga ana e Qendrës Socio-Shëndetësore Vorë, sa i përket trajtimit të saj gjatë marrëdhënieve të punësimit, krahasuar me kolegë të tjera të cilat ndodhen në kushte të njëjta me të.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e Qendrës Socio-Shëndetësore Vorë, lidhur me trajtimin të saj gjatë marrëdhënieve të punësimit.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm të subjektit ankues, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pabarabartë apo të pafavorshëm të tij, të lidhur domosdoshmërisht me “shkakun” e pretenduar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, znj. M. M., në fushën e punësimit, kundër znj. Sh. G., Drejtoreshë e Qendrës Socio-Shëndetësore Vorë, në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “*bindjeve politike/filozofike*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA